



SHSASHJ
Shoqata Sindikale e Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës
Sindikalna Podružnica Članova Službe Inostranih Poslova Republike Kosovo
Trade Union Association of the Members of Foreign Service of the Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRI I PUNËVE TË BASHKËPUNËSIAVE DIPLOMATIKE DIPLOMATIČKI ODELJ ZA ADMINISTRACIJU DOKUMENTA I ARHIVIRANJE			
Njësia Org Org Jediti Org Unit	2-0	Nr Prot Br Prot Prot No	5150
No. Emissio No. Pagine	1	Data Date	10.11.2023
Prishtinë / a			

Situatë alarmante në MPJD

Ftohen institucionet përgjegjëse të intervenojnë urgjentisht

Komunikatë për media

Shkeljet ligjore, mos respektimi i kriterëve për ngritje në gradë dhe në procesin e rotacionit, dërgimi i diplomatëve të papërvojë me një kohëzgjatje vetëm disamujsh, emërimet politike, lëvizja e diplomatëve pas disa muajve akreditimi nga një mision në tjetrin, mbajtja e pozitave me ushtrues detyre apo me zëvendësues për më shumë se 20 muaj, mos respektimi i kriterëve për pranim në punë, transferimet pa kurrfarë kriteresh nga resorë tjerë qeveritarë në MPJD, transferimet pa asnjë kriter brenda MPJD-së, ulja e pagave të anëtarëve të shërbimit jashtë vendit dhe aplikimi i standardeve të shumëfishta, janë vetëm disa nga shqetësimet e identifikuara.

Shoqata e Anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm (tutje në tekst SHSASHJ) ka informuar institucionet kryesore të vendit me këto gjetje si dhe ka tentuar që këto shqetësime t'i adresoj tek lidhshipi politik dhe profesional i MPJD-së dhe jo vetëm, por ka hasur në vesh të shurdhër. Tutje, SHSASHJ në vazhdimësi ka shprehur interesim dhe gatishmëri për të ofruar kontributin e vet në azhurnimin e legjislacionit dhe politikave që e rregullojnë politikën e jashtme, me synim avancimin jo vetëm të interesave të shërbyesve civil dhe diplomatëve, por në ngritjen e përgjithshme të cilësisë në MPJD e misionet diplomatike dhe konsullore si dhe rrjedhimisht përmirësimin e imazhit të Republikës së Kosovës.

Veprimet brenda MPJD-së, mungesa e llogaridhënies dhe e transparencës, janë po ashtu në kundërshtim të plotë edhe me parimet e Administratës Publike të zhvilluara nga SIGMA, në një nismë të përbashkët të BE-së dhe OECD-së, e financiar kryesisht nga BE-ja, me kërkesë të Komisionit Evropian (KE për të udhëzuar administratat e zgjerimit dhe fqinjësisë së Bashkimit Evropian (BE) në përpjekjet e tyre reformuese për të trajtuar mangësitë e administratave të tyre publike dhe për të përmbushur kërkesat e BE-së për një "reformë themelore" të procesit të anëtarësimit.

Prandaj, në mungesë të mundësisë për të adresuar përbrenda institucionit shqetësimet e zyrtarëve të MPJD-së, SHSASHJ me shumë keqardhje, përmes kësaj komunikate njofton opinionin e gjerë publik për **situatën alarmante** të krijuar në Ministrinë për Punë të Jashtme dhe Diasporë të Republikës së Kosovës. Në të njëjtën kohë i bën thirrje urgjente institucioneve përgjegjëse shtetërore për monitorimin e punës së MPJD-së dhe fton organet përkatëse të zbatimit të ligjit që të nisin hetimin e shkeljeve të drejtave të punëtorëve/shërbyesve civil.

Prishtinë, 23 tetor 2023

Këshilli Ekzekutiv i SHSASHJ-së-MPJD